



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:016651
Datë: 14.03.2024
Numri i dokumentit: 05454889

PPP.nr.21/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në lëndën përbarimore të kreditorit Telekom i Kosovës sh.a, me seli në Prishtinë, kundër debitorit F.S. nga fsh ..., Komuna e Ferizajt, duke vendosur në ankesën e debitorit për parregullsi, të ushtruar kundër veprimeve të përbaruesit privat I.M., në lëndën P.nr.465/16, më datë 14.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si e pabazuar ankesa për parregullsi e debitorit F.S., e ushtruar kundër urdhrit P.nr.465/16, të datës 13.01.2022, i nxjerrë nga Përbaruesi Privat I.M. dhe **MBETET në fuqi** urdhri P.nr.465/16, i datës 13.01.2022.

A r s y e t i m

Nga shkresat e lëndës P.nr.465/16, Gjykata ka konstatuar se kreditori Telekom i Kosovës sh.a, me datë 16.08.2016, ka ushtruar propozim për përbarim kundër debitorit Fadil Sejdi dhe Përbaruesi privat I.M., me urdhrin P.nr.465/16, të datës 16.08.2016, e ka caktuar përbarimin kundër debitorit, ndërsa kundër urdhrit për përbarim debitori siç shihet nga shkresat e lëndës nuk ka ushtruar prapësim.

Me datë 20.01.2022, debitori F.S., ka dorëzuar në këtë gjykatë ankesën për parregullsi kundër veprimeve përbarimore të Përbaruesit Privat I.M., në urdhrin P.nr.465/16, të datës 13.01.2022.

Përmbaruesi Privat I.M. ka ushtruar përgjigje me shkrim në ankesën e debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj ankesën për parregullsi të debitorit si të pabazuar.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të ankesës së debitorit dhe pretendimeve në të, gjeti se ankesa për parregullsi e ushtruar kundër urdhrin P.nr.465/16, të datës 13.01.2022, të lëshuar nga Përmbaruesi privat I.M., është e pabazuar.

Sa i përket pretendimeve të debitorit në ankesë se nga llogaria ime në bankë është tërhequr sipas urdhrin për përmbarim P.nr.465/16, shuma totale e mjeteve prej 349.67 euro dhe që nga kjo kohë llogaria ime ka qenë e zhbllokuar nga Përmbaruesi privat. Në muajin dhjetor më ka kontaktuar zyra përmbarimore M. SH.P.K dhe më ka thënë se unë duhet të paguaj edhe një shumë tjetër shtesë sipas këtij urdhri përmbarimor në vlerë prej 412.37 euro, dhe arsyetimi i tyre ishte se për shkak të punëve të shumta kanë harruar ta përmbushin këtë vendim përmbarimor, dhe me dt. 17.01.2021 kam shkruar t'i tërheq mjetet në llogarinë time dhe aty jam njoftuar se llogaria është bllokuar sipas vendimit përmbarimor P.nr.465/16, gjykata këto pretendime i konsideron të pa bazuar sepse nga shkresat e lëndës, gjegjësisht nga urdhri P.nr.465/16, i dt. 06.09.2015, konstatohet se përmbaruesi privat në rastin konkret me këtë urdhër i ka urdhëruar të gjitha bankat komerciale në Kosovë që ti japin të dhëna lidhur me gjendjen e llogarive bankare të debitorit F.S. dhe ndër të tjera në këtë urdhër nga përmbaruesi privat është specifikuar edhe shuma e përgjithshme e borxhit bashkë me shpenzimet e përmbarimit prej 834.93 euro. Po ashtu me urdhrin e dt.27.9.2016, përmbaruesi privat e ka detyruar TEB Sh.A që shumën e mjeteve prej 811.33 euro nga paga e debitorit ta transferoj në llogarinë e veçantë të përmbaruesit privat edhe atë që të bëj transferin prej ½ e pagës së debitorit për çdo muaj deri në përmbushjen e plotë të detyrimit. Gjithashtu përmbaruesi privat I.M., me urdhrin e dt. 31.07.2018, i ka urdhëruar të gjitha bankat komerciale në Kosovë që ta bëjnë de bllokimin e llogarive të bllokuara të debitorit, kurse me urdhrin e dt 13.01.2022 sërish i ka urdhëruar të gjitha bankat komerciale në Kosovë që ti bllokojnë llogaritë e debitorit edhe atë për shumën e mbetur të borxhit kryesor dhe të shpenzimeve të përmbarimit në shumën e përgjithshme prej 412.37 euro.

Përveç tjerash, nga shkresat e lëndës nuk vërtetohet se debitori ka lidhur ndonjë marrëveshje me përmbaruesin privat apo me kreditorin që shumën e borxhit ta paguaj përkatësisht ti ndalet debitorit nga llogaria e tij shuma prej 30 euro për çdo muaj. Andaj duke i marr për bazë faktet e përmendura më lart gjykata konsideron se urdhri P.nr.465/16, i datës 13.01.2022 është lëshuar në pajtim të plotë me dispozitat e neneve:127, 143, 152, 154, 155, 157, 158, par 1 dhe 3, 159, par 1, 160, 161, 162, 165 dhe 341, të LPP-së. Po ashtu nga shkresat

e lëndës nuk shifet se përmbaruesi privat në rastin konkret, pas nxjerrjes së urdhrin për de bllokim të llogarive të debitorit të dt 31.07.2018, të ketë marr ndonjë aktvendim për përfundim të procedurës së përmbarimit.

Për më tepër, shuma e mjeteve e bllokuar me urdhrin e dt. 13.01.2022, nga përmbaruesi privat në rastin konkret është shumë e mbetur e borxhit të përgjithshëm sa ishte i cekur në urdhrin e dt. 06.09.2015, që nënkupton se në këtë shumë janë të përfshira përveç borxhit kryesor edhe shpenzimet e përmbarimit. Prandaj përmbaruesi privat I.M. urdhrin e datës 13.01.2022, e ka nxjerr në pajtim të plotë me të gjitha dispozitat ligjore gjegjëse të cilat janë përmendur më lartë.

Gjithashtu sa i përket pretendimit të debitorit në ankesë se në rastin konkret borxhi i debitorit , borxhi të cilin kreditori e kërkon është parashkruar konform nenit 342 dhe 352 të LMD-së është parashkruar gjykata këtë pretendim e konsideron në tërësi të pa bazuar për faktin se kreditori propozimin e tij për përmbarim e ka ushtruar brenda periudhës kohore të paraparë me nenin 360, par 1, nën par 1.3, të LMD-së, sepse faturat në bazë të cilave është kërkuar përmbarimi janë nga muaji 12, i vitit 2015 e deri më 01.10.2016, që nënkupton në rastin konkret nuk mund të bëhet fjalë për parashkrim të kërkesës së kreditorit.

Si përfundim, gjykata konstaton se Përmbaruesi privat I.M., urdhrin për bllokim të llogarive bankare të debitorit P.nr.465/16, të datës 13.01.2022, e ka nxjerrë në pajtim të plotë ndërmarrë në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të neneve: 127, 143, 152, 154, 155, 157, 158, par 1 dhe 3, 159, par 1, 160, 161, 162, 165 dhe 341, të LPP-së

Andaj, Gjykata duke i marr për bazë të cekurat më lart dhe në bazë të nenit 5, par 5, dhe nenit 79, par 1, 2 dhe 3, të LPP - së, vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.21/22, më datë 14.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë.